

VENDIM
Nr.14, datë 13.1.1997

PËR PRODHIMIN E PULLAVE TË TAKSAVE NGA SHOQËRIA ANONIME
KARTOGRAFIKE NË TIRANË

Në zbatim të pikës 3 të nenit 17, të pikës 1 të nenit 19 dhe nenit 37 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 6 të ligjit nr.8002, datë 27.9.1995 “Për administrimin dhe përdorimin e pullave të taksave”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Financave të kryejë prokurim të drejtpërdrejtë me Shoqërinë Anonime Kartografike për shtypjen e 300 mijë copë pulla takse me vlerë nominale 20 lekë, sipas kushteve që do të vendosen ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Shoqërisë Anonime Kartografike në Tiranë.

2. Me shtypjen e kësaj sasive, prodhimi i pullave të taksave do të vazhdojë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.534, datë 19.8.1996 “Për prodhimin e pullave të taksave”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi